

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
13	Autoritetet duhet t'i njohin më mirë zgjedhësit me teknologjitë zgjedhore dhe të ofrojnë akses të barabartë në procesin e votimit. Duhet të merren masa për t'u mundësuar zgjedhësve që përdorin teknologji të reja të votojnë në mënyrë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë.	Progres i Moderuar	Në planin e punës së KQZ për zbatimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhje janë parashikuar aktivitete për informimin e zgjedhësve. Pjesë e këtij procesi informimi duhet të jenë edhe organizata të shoqërisë civile. Informimi është i nevojshëm të bëhet për: • Përdorimin e teknologjise së informacionit për identifikimin biometrik të zgjedhësve – Kjo mënyrë identifikimi do të zbatohet në të gjithë territorin e vendit. • Përdorimi i teknologjise së informacionit për votimin elektronik në qendrën e votimit – Ky votim do të zbatohet vetëm në qarkun e Elbasanit dhe Durrësit.